



Одговорност, Технологија и Мрежа
на Институционална Отвореност
во Југоисточна Европа

Udhërrëfyes rajonal për qeverisje të mirë në Ballkanin Perëndimor

Hapat e veprimit për rekomandimet e
përbashkëta nga udhërrëfyesit e vendeve të
përgatitura nga rrjeti ACTION SEE

Në bazë të indeksit rajonal të shkallës së
hapjes së institucioneve shtetërore

Në bazë të
matjes për
vitin 2018

Shkup, nëntor 2019



Ky projekt është financuar
nga Bashkimi Evropian

METAMORPHOSIS

WESTMINSTER
FOUNDATION FOR
DEMOCRACY

CRTA

ZaštoNe?

QENDRA ZA
DEMOKRATSKU
TRANZICIJU

ODK
OPEN DATA KOSOVO

MJAFT!

Projekti Përgjegjësi, Teknologji dhe Rrjeti i institucioneve të hapura në Evropën Juglindore – ACTION SEE, implementohet nga Fondacionit Metamorfozis, Fondacioni Westminster për demokraci, CRTA – Qendra për hulumtim, transparencë dhe llogaridhënie, Shoqata e qytetarëve “Why not?”, Qendra për tranzicion demokratik -CDT, Open Data Kosovo (ODK), dhe Lëvizja Mjaft!





Udhërrëfyes rajonal për qeverisje të mirë në Ballkanin Perëndimor

Hapat e veprimit për reko-
mandimet e përbashkëta
nga udhërrëfyesit e vendeve
të përgatitura nga rrjeti AC-
TION SEE

Në bazë të indeksit rajonal të sh-
kallës së hapjes së institucioneve
shtetërore

Në bazë të matjes për vitin 2018

Shkup, nëntor 2019

BOTUES:

METAMORPHOSIS 

Metamorfozis - Fondacioni për internet dhe shoqëri

Misioni i Fondacionit Metamorfozis është të kontribuojë në zhvillimin e demokracisë dhe ta rrisë cilësinë e jetës përmes përdorimit inovativ dhe shpërndarjes së njohurive. Vlerat tona kryesore janë transparenca, barazia dhe liria.

Adresa: Apostoll Gusllarot 40, 1000 Shkup,
Maqedonia e Veriut
Tel: +389 3109 325
Faksi: +389 3225 206
Ueb-faqja: www.metamorphosis.mk
E-mail-i: contact@metamorphosis.org.mk

PËR BOTUESIN:

Bardhyl Jashari

REDAKTORË:

Bardhyl Jashari- Fondacioni për Internet dhe Shoqëri
Emil Atanasovski- Drejtor për Ballkanin Perëndimor në
Fondacionin Westminster për Demokraci

BASHKËPUNËTORË:

Aida Ajanoviç, Blerina Ramaj, Danira Markoviç, Milla Josifovska Danillovska, Dragan Koprivica, Tamara Brankoviç, Xheni Lame



Projekti ACTION SEE- Përgjegjësi, Teknologji dhe Rrjet i institucioneve të hapura në Evropën Juglindore ka për qëllim ta rrisë përfshirjen e shoqërisë civile dhe organizatave mediatike në proceset e vendimmarrjes dhe krijimit të opinionit publik dhe hartimit të politikave, si dhe ta ngrisë kapacitetin e shoqërive civile për të zgjidhur çështje të ndjeshme.

Ky publikim është përgatitur me ndihmën e Bashkimit Evropian. Për përmbajtjen e këtij publikimi përgjegjësi të vetme kanë partnerët e projektit ACTION SEE dhe në asnjë mënyrë nuk duhet të supozohet se ai i reflekton qëndrimet e Bashkimit Evropian.

KOORDINATOR I PROJEKTIT

Fondacioni Metamorfozis
Maqedonia e Veriut
Ueb-faqja: www.metamorphosis.org.mk

ORGANIZATAT PARTNERE:

Fondacioni për Demokraci - Westminster
Britani e Madhe
Ueb-faqja: www.wfd.org

CRTA - Qendra për Huluntim,
Transparençë dhe Përgjegjshmëri
Serbi
Ueb-faqja: www.crt.rs

Shoqëria qytetare "Zashto ne"?
Bosnje dhe Hercegovinë
Ueb-faqja: www.zastone.ba

Qendra për Tranzicion Demokratik
Mali i Zi
Ueb-faqja: www.cdtmn.org

Open Data Kosovo (ODK)
Kosovë
Ueb-faqja: www.opendatakosovo.org

Lëvizja Mjaft!
Shqipëri
Ueb-faqja: www.mjaft.org

CIP - Каталогизација во публикација
Национална и универзитетска библиотека "Св. Климент Охридски", Скопје

334.724.6:005.332.5(497-15)(047.31)

UDHËRRËFYES rajonal për qeverisje të mirë në Ballkanin Perëndimor :
hapat e veprimt për rekomandimet e përbashkëta nga udhërrëfyesit e vendeve
të përgatitura nga rrjeti ACTION SEE : në bazë të indeksit rajonal të shkallës së
hapjes së institucioneve shtetërore :
në bazë të matjes për vitin 2018 / [redaktorë Bardhyl Jashari, Emil Atanasovski].
- Shkup : Metamorfozis fondacioni, 2020. - 32 str. ; 25 cm

ISBN 978-608-263-026-7

C PËRMBAJTJA

1. HYRJE DHE INFORMATA TË PËRGJITHSHME	7
2. INSTITUCIONET SHTETËRORE	8
2.1. PUSHTETI EKZEKUTIV	8
HAPAT E VEPRIMIT	9
2.2. KUVENDI	12
HAPAT E VEPRIMIT	14
2.3. GJYQËSIA	17
HAPAT E VEPRIMIT	18
2.4. NJËSITË E VETËQEVERISJES LOKALE (KOMUNAT)	21
Hapat e veprimit	23
3. METODOLOGJIA	27
4. PROJEKTI	28
5. LEXONI MË SHUMË	29



1. HYRJE DHE INFORMATA TË PËRGJITHSHME

Ky dokument duhet të përdoret si një përmbledhje e përgjithshme e problemeve të zakonshme me të cilat përballen vendet e Ballkanit Perëndimor për sa i përket hapjes, të përcaktuara sipas standardeve ndërkombëtare. Mund të përdoret gjithashtu si një udhëzues që i përmban hapat më urgjentë të veprimit që duhet t'i ndërmarrin të gjitha vendet për të përmirësuar shkallën e hapjes së institucioneve të tyre. Projekti ACTION SEE përgatiti udhërrëfyes për secilin nga vendet e Ballkanit Perëndimor, të cilët përmbajnë propozime të hollësishme për hapat e veprimit që duhet të ndërmerren nga secili nga institucionet e përfshira në matje. Megjithatë, udhërrëfyesi rajonal i përmban rekomandimet më të rëndësishme për rajonin në tërësi.

Hapja është kusht kryesor për demokraci pasi që u mundëson qytetarëve t'i marrin informatat dhe njohuritë e nevojshme për pjesëmarrje të barabartë në jetën politike, vendimmarrjen efikase dhe përgjegjësinë e institucioneve për politikën që i zbatojnë. Institucionet në gjithë botën ndërmarrin aktivitete konkrete për ta rritur transparencën dhe llogaridhënien e tyre ndaj qytetarëve.

Qeverisja e hapur bazohet në katër parime organizative: transparencë, qasje, integritet dhe vetëdije. Këto parime zbatohen në të gjitha degët dhe nivelet e pushtetit, nga pushteti ekzekutiv qendror deri tek vetëqeverisja lokale, kuvendi dhe gjyqësia.

Indeksi i shkallës së hapjes është një tregues i përbërë që e mat shkallën në të cilën qeveritë në vendet e Ballkanit Perëndimor janë të hapura për qytetarët dhe shoqërinë dhe është dizajnuar për ta përcaktuar shkallën në të cilën qytetarët e Ballkanit Perëndimor marrin informacione të dobishme dhe

të kuptueshme nga institucionet e tyre.

Për të matur shkallën e hapjes institucionale, partnerët e ACTION SEE, duke iu përmbajtur standardeve ndërkombëtare, rekomandimeve dhe shembujve të praktikës së mirë, i vlerësuan institucionet përmes treguesve specifikë sasiorë dhe cilësorë, të cilët i vlerësojnë institucionet në bazë të: qasjes në informacionin që janë në dispozicion në ueb-faqet zyrtare të institucioneve, cilësisë së kornizës ligjore për rastet individuale, burime të tjera të informimit publik dhe pyetësorëve të dorëzuara në institucione.

Au përgjigjen institucionet në pyetësorët e dorëzuar ishte një tregues shtesë i shkallës së hapjes së tyre. Shumë institucione morën rezultate negative për sa i përket treguesve sepse nuk iu përgjigjen pyetësorit, që është gjithashtu me rëndësi për t'u përmendur për dy arsye: së pari, sepse përgjegjësia institucionale është një tregues i hapjes dhe së dyti, se papërgjegjësia e institucioneve ka ndikim negativ në rezultatin e tyre, sepse ato u vlerësuan automatikisht me 0. Përveç kësaj, disa prej treguesve mund të vlerësoheshin pozitivisht vetëm nëse ekziston zbatimi i ligjeve ekzistuese.

Matja është realizuar nga dhjetori i vitit 2018 deri në fund të marsit të vitit 2019. Duke u bazuar në rezultatet e hulumtimit, të dhënat dhe gjetjet u zhvilluan një sërë rekomandimesh dhe udhëzimesh për institucionet.

Hapat e rekomanduar për secilën kategori të institucioneve bëhen në bazë të treguesve që nuk janë përmbushur plotësisht.

Lexuesit mund ta lexojnë metodologjinë dhe informacionin e përgjithshëm për projektin në fund të këtij publikimi.



2. INSTITUCIONET SHTETËRORE

2.1. PUSHTETI EKZEKUTIV

Për të tretin vit radhazi, institucionet e pushtetit ekzekutiv të Ballkanit Perëndimor përbushin nën 50% të treguesve të shkallës së hapjes. Megjithëse rezultati prej mbi 48% i treguesve të përbushur është pak më i mirë se dy vitet e kaluara kur janë kryer matjet, nuk ka pasur ndryshime më domethënëse. Udhëheqësit individualë për sa i përket shkallës së hapjes kanë kontribuar në një përmirësim të vogël të rezultateve, gjë që vërteton se hapja akoma trajtohet në baza ad hoc. Megjithatë, ndryshime rrënjësore, siç janë politikat e planifikuara të hapjes dhe zbatimi i tyre konsekuent në të gjitha vendet, ende nuk kanë ndodhur.

Lider për sa i përket shkallës së hapjes së institucioneve të pushtetit ekzekutiv është Mali i Zi, me përbushje të treguesve prej 62%. Marrë në përgjithësi, qeveritë në rajon e Ballkanit Perëndimor mesatarisht përbushin 63,62% të treguesve të shkallës së hapjes, ministritë e linjës 50%, ndërsa organet e administratës shtetërore, 32,22%. Rezultatet e konfirmuan edhe një herë se institucionet e pushtetit ekzekutiv janë më të hapura duke shkuar drejt niveleve më të larta organizative të pushtetit.





Parimet e transparencës proaktive dhe hapjes së institucioneve të pushtetit ekzekutiv të Ballkanit Perëndimor nuk janë në nivel të kënaqshëm. Nga një vend në tjetrin, nga një institucion në tjetrin, dokumentet kryesore që i ofrojnë publikut pasqyrë në planet e punës, rezultatet e arritura dhe zhvillimet financiare të këtyre institucioneve nuk janë në dispozicion të publikut. Publiku gjithashtu nuk ka qasje në procesin e vendimmarrjes. Mbledhjet e qeverive janë të mbyllura për qytetarët, ndërsa procesverbalet, si dhe dokumentet që shqyrtohen, shumë rrallë janë në dispozicion në ueb-faqet e institucioneve.

Ueb-faqet e vjetra e bëjnë të vështirë qasjen në dokumente që janë në dispozicion publike, të cilat edhe ashtu janë në numër të vogël. Edhe pse sistemet e qeverisjes elektronike (e-qeveri) ekzistojnë në të gjitha vendet, ato nuk përdoren sa duhet dhe janë të paarritshme për qytetarët dhe publikun.

Duke marrë parasysh atë që u tha më sipër, rekomandimi kryesor për përmirësimin e hapjes së institucioneve të pushtetit ekzekutiv mbetet i njëjtë. Duhet të miratohen dokumente strategjike dhe plane aksionale vjetore në lidhje me zhvillimin e shkallës së hapjes, për mes të cilave duhet të sigurohet njëtrajtshmëri në hapjen e institucioneve të pushtetit ekzekutiv. Miratimi dhe zbatimi konsequent i dokumenteve të tilla dhe i planeve aksionale, si dhe zbatimi konsequent i dokumenteve ekzistuese, të cilat e garantojnë hapjen e tyre, janë mënyrë për të arritur një hapje më të madhe të institucioneve të pushtetit ekzekutiv.

HAPAT E VEPRIMIT

Transparenca

-  Krijimi i një ueb-faqeje zyrtare që do të azhurnohet vazhdimisht me informacione përkatëse dhe e cila ka një mjet funksional për kërkim.
-  Publikimi i planeve të punës dhe i raporteve të aktiviteteve të realizuara në tre vitet e fundit në ueb-faqet zyrtare (tremujore/gjysmë-vjetore/vjetore).
-  Publikimi i Rregulloreve të punës dhe/ose procesverbaleve të mbledhjeve të Qeverisë, dokumenteve të shqyrtuara në mbledhje, si dhe të dokumenteve të miratuara nga Qeveria në ueb-faqet zyrtare.
-  Publikimi i strukturës organizative të institucioneve në ueb-faqe, duke i përfshirë kompetencat e institucionit, biografi të rëndësishme dhe listë të të gjithë punonjësve, por, nëse është e nevojshme, edhe kontaktet dhe rrogat e tyre për secilën pozicion në institucion.

- ☒ Publikimi i të gjitha dokumenteve financiare në ueb-faqen e internetit të institucionit (buxhetet vjetore, shpenzimet buxhetore dhe raportet përkatëse, rebalanci i buxhetit).
- ☒ Publikimi i të gjitha dokumenteve që lidhen me procedurat e furnizimeve publike, duke i përfshirë planet vjetore, thirrjet e hapura, vendimet për furnizime dhe kontratat e lidhura, me çdo ndryshim të lidhur.
- ☒ Krijimi i një Buxheti për qytetarët për t'i kuptuar më mirë zhvillimet financiare të institucioneve ekzekutive.
- ☒ Ruajtja e dokumenteve të arkivuara dhe prezantimi i tyre në ueb-faqet zyrtare.

Disponueshmëria

- ☒ Publikimi i regjistrave të dokumenteve në ueb-faqet zyrtare.
- ☒ Publikimi i një udhëzuesi të azhurnuar për qasje në informacione në ueb-faqet zyrtare që i përmbajnë detajet e kontaktit të zyrtarëve përgjegjës.
- ☒ Monitorimi i afateve në lidhje me qasjen në informata.
- ☒ Edukimi i punonjësve për mundësinë e qasjes në arkivat e dokumenteve dhe zbatimin adekuat të ligjeve për qasje të lirë në informata.
- ☒ Sigurimi se ligjet për qasje të lirë në informata janë të detyrueshme për institucionet përkatëse dhe se ato zbatohen në mënyrë konsekuente, por edhe një organ i pavarur përgjegjës për zbatimin e ligjit për qasje të lirë në informata është një zgjidhje e mundshme për të siguruar qasje të plotë.
- ☒ Publikimi i informatave për të cilat tashmë miratuar qasje e lirë.

- ☒ Çdo institucion ekzekutiv duhet të ketë një strategji të zhvilluar për të komunikuar me qytetarët dhe publikun e gjerë.
- ☒ Përdorimi i mjeteve të komunikimit në internet me qytetarët, duke përfshirë komunikimin përmes mediave sociale.
- ☒ Përmirësimi i procesit të konsultimit publik dhe i përdorimit i mjeteve për konsultime në internet. Të gjitha informacionet e nevojshme në lidhje me konsultimet publike duhet të publikohen në ueb-faqen zyrtare të institucionit, duke përfshirë edhe raportet për konsultimet e kryera.
- ☒ Sigurimi se të gjitha informacionet e publikuara janë në format të hapur të të dhënave.

Integriteti

- ☒ Miratimi i planit për integritet ose cilës do qoftë politike tjetër të brendshme për luftë kundër korrupsionit, e cila përfshin masa për parandalimin dhe eliminimin e formave të ndryshme të sjelljes korruptive dhe joetike brenda institucionit.
- ☒ Publikimi i raporteve për pronën e personave zyrtarë në ueb-faqet zyrtare në formatin e hapur të të dhënave.
- ☒ Implementimi i sistemit të sanksionimit të atyre zyrtarëve që paraqesin informacione të rrejshme në raportet e tyre të pronës.
- ☒ Përcaktimi i procedurave për zbatimin e plotë të kodeve të etikës dhe i sanksioneve për shkeljen e tyre.
- ☒ Rregullimi i aktiviteteve të lobimit.
- ☒ Edukimi i punonjësve për konfliktin e interesit, parandalimin e korrupsionit dhe spiunimin.



Vetëdija

- ✚ Krijimi i procedurave të planifikimit dhe kontrollit cilësor të mënyrës së zbatimit të politikave dhe ndikimit të tyre.
- ✚ Krijimi i treguesve për vlerësimin e efikasitetit të secilës politikë të zbatuar.
- ✚ Implementimi i një sistemi të unifikuar të raporteve të detyrueshme vjetore të secilit institucion.
- ✚ Krijimi i një sistemi për rregullimin e konsultimeve ndërministrore, duke përfshirë publikimin e raporteve për konsultimet në ueb-faqet zyrtare të secilit institucion.

2.2 KUVENDI

Organet ligjvënëse të vendeve të Ballkanit Perëndimor arritën rezultat pak më të mirë këtë vit në krahasim me shkallën e hapjes së vitit të kaluar, dhe ato përbushin 66% të treguesve të hapjes. Megjithëse, përparimi nuk është i madh në përqindje (vetëm 5%), megjithatë ai është i rëndësishëm duke pasur parasysh futjen e kriterëve më të rrepta për matjen e shkallës së hapjes vitin e kaluar. Megjithatë, shkalla e hapjes nuk është në nivel të kënaqshëm.

Rezultate të rëndësishme u arritën nga Kuvendet e Malit të Zi dhe të Kosovës, me përbushje prej 79% dhe 72% të treguesve të hapjes, ndërsa Kuvendet e Bosnjë dhe Hercegovinës ishin në vendet e fundit në listën e shkallës së hapjes me përbushje prej 46%. Gjithashtu është vërejtur mungesë e njëtrajtshmërisë në hapjen e Kuvendeve në rajon, me ndryshime të mëdha midis vendeve.

Ende nuk ka qasje strategjike për ndërtimin e hapjes sistematike të Kuvendeve dhe për ndjekjen e parimeve të transparencës proaktive. Çdo Kuvend e ndërton hapjen e tij duke zbatuar dokumente të ndryshme, të cilat interpretohen ndryshe varësisht nga konteksti. Kjo qasje çon në nivele të ndryshme të hapjes së këtyre institucioneve.

Fakti që tre kuvende në rajon nuk iu përgjigjën pyetësorit që iu dërgua atyre përmes këtij projekti është gjithashtu një tregues i gjendjes brengosëse në lidhje me hapjen e tyre.

Megjithëse transparenca e kuvendeve ngadalë rritet, mundësia për qasje të qytetarëve në këto institucione është duke ngecur. Rezultatet e hulumtimit tregojnë se nuk po ndërmerret asgjë aktive për ta ndryshuar këtë gjendje. Nga të gjitha vendet e rajonit, Bosnja dhe Hercegovina është në nivelin më të ulët në këtë drejtim.

Proaktiviteti në publikimin e informatave për punën e kuvendeve është ende vetëm politikë e shkruar në letër. Përderisa dhomat e kuvendeve publikojnë një sasi të caktuar informacionesh për punën e tyre, situata me komisionet që punojnë në kuadër të kuvendeve është krejtësisht e kundërt. Është pothuajse e pamundur të gjenden informacione për punën e tyre.

Dokumentet ende nuk publikohen në format të lexueshëm nga makinat.

Hendeku midis qytetarëve dhe këtyre institucioneve po zgjerohet pasi ndërveprimi me qytetarët zvogëlohet. Në këtë kontekst, vendet me renditjen më të dobët janë Serbia dhe Bosnja dhe Hercegovina.

Planifikimi strategjik i kuvendeve në nivel rajonal është edhe më i ulët se në vitet e kaluara. Puna e kuvendeve ende nuk bazohet ende në krijimin e një metodologjie të qëndrueshme dhe treguesve adekuatë për matjen e rezultateve dhe cilësisë së punës së tyre dhe punës së deputetëve.

Kuvendet në rajonin e Ballkanit Perëndimor vazhdojnë të kenë baza të mira për zbatimin e mbikëqyrjes parlamentare. Megjithatë, është i nevojshëm një përforsim i konsiderueshëm i mbikëqyrjes parlamentare në të gjithë rajonin, me theks në zbatimin e plotë të tij në praktikë.


Serbia iu bashkua Maqedonisë së Veriut dhe Malit të Zi si vend që miratoi rregullativë në fushën e lobimit. Megjithatë, Serbia mbetet vendi i vetëm në rajon që nuk ka Kod etik për deputetët.



HAPAT E VEPRIMIT

Transparenca

- ☒ Planifikimi strategjik i hapjes së kuvendeve rajonale.
- ☒ Ueb-faqet zyrtare të kuvendeve duhet të azhurnohen rregullisht me informacione përkatëse dhe të kenë mjet funksional për kërkim.
- ☒ Publikimi i planeve për punë dhe i raporteve për aktivitetet e realizuara në tre vitet e kaluara në ueb-faqet zyrtare (tremujore/gjysmë-vjetore/vjetore).
- ☒ Publikimi i Rregulloreve të punës dhe/ose procesverbaletë të mbledhjeve të Kuvendeve, së bashku me ligjet dhe dokumentet që shqyrtohen në këto mbledhje, si dhe i ligjeve dhe i dokumenteve të miratuara nga kuvendet në ueb-faqet zyrtare.
- ☒ Praktika e miratimit të ligjeve përmes procedurës urgjente ose të përsheptuar duhet të kufizohet në kushtet e parashikuara, në mënyrë që të sigurohet një proces cilësor i konsultimit me publikun.
- ☒ Publikimi i informacioneve për atë se si deputetët votojnë në mbledhjet plenare.
- ☒ Krijimi i dhe zbatimi i mekanizmave të raportimit për përfaqësuesit parlamentarë dhe aktivitetet e tyre zyrtare.
- ☒ Publikimi i video transmetimeve dhe incizimeve nga mbledhjet plenare.
- ☒ Lista e emrave, pozicioneve dhe detajeve të kontaktit të nëpunësve shtetërorë duhet të publikohet në ueb-faqet zyrtare, duke i përfshirë kategoritë e rrogave të nëpunësve publikë.
- ☒ Publikimi i të gjitha dokumenteve financiare, përfundimtare dhe gjysmë-vjetore, në ueb-faqen e institucionit (buxhetet vjetore, shpenzimet buxhetore dhe raportet përkatëse, rebalanci i buxhetit).



- ☒ Publikimi i të gjitha dokumenteve që lidhen me procedurat e furnizimeve publike, duke i përfshirë planet vjetore, thirrjet e hapura, vendimet për furnizime dhe kontratat e lidhura, me çdo ndryshim të lidhur.
- ☒ Kuvendet duhet ta përmirësojnë hapjen e organeve të tyre të punës (komisioneve) duke njoftuar për praninë e deputetëve në mbledhje, duke i publikuar procesverbalet dhe videot e këtyre mbledhjeve, si dhe procesverbalet e votimit.
- ☒ Përgatitja dhe publikimi i Buxhetit të qytetarëve në ueb-faqet zyrtare të kuvendeve.
- ☒ Sigurimi se të gjitha informacionet e publikuara janë në format të hapur të të dhënave.

Disponueshmëria

- ☒ Ueb-faqet e kuvendeve duhet të përmbajnë informacione për personin përgjegjës për qasje në informatat me rëndësi për publikun.
- ☒ Lista e informatave me karakter publik duhet të azhurnohet dhe të publikohet në ueb-faqet e Kuvendeve.
- ☒ Arkivi i të gjitha dokumenteve duhet të mirëmbahet rregullisht dhe të publikohet në ueb-faqet zyrtare.
- ☒ Krijimi i një detyrimi ligjor për të ofruar trajnime në fushën e qasjes në informatat me karakter publik.
- ☒ Sigurimi se ligjet për qasje të lirë në informata janë të detyrueshme për institucionet e ndërlidhura dhe se ato zbatohen në mënyrë konsekuente, por edhe një organ i pavarur përgjegjës për zbatimin e ligjit për qasje të lirë në informata është një zgjidhje e mundshme për të siguruar qasje të plotë.
- ☒ Publikimi i kërkesave të pranuarra për qasje në informata.









- ☒ Publikimi i informatave për të cilat tashmë është miratuar qasje e lirë.
- ☒ Krijimi i udhëzimeve për ankesa dhe publikimi i ankesave në ueb-faqe.
- ☒ Krijimi i një kanali të drejtpërdrejtë për komunikim përmes internetit, përmes të cilit qytetarët mund t'i shprehin shqetësimet e tyre dhe të paraqesin vërejtje dhe ankesa.
- ☒ Krijimi i kanaleve të reja të komunikimit me qytetarët përmes rrjeteve sociale dhe peticioneve në internet.
- ☒ Krijimi i një sistemi për përfshirjen e publikut në konsultimet për legjislacionin në procedurat parlamentare.
- ☒ Sigurimi se të gjitha informacionet e publikuara janë në format të hapur të të dhënave.

Integriteti

- ☒ Miratimi i kodeve të etikës me procedura të qarta për mbikëqyrje.
- ☒ Publikimi i kodeve të etikës në ueb-faqet zyrtare, si dhe kush është përgjegjës për mbikëqyrjen e tyre.
- ☒ Rishikimi dhe përmirësimi i vazhdueshëm i kodeve aktuale të etikës.
- ☒ Publikimi i listave të pronës së të gjithë anëtarëve të kuvendeve në ueb-faqet zyrtare.
- ☒ Rregullimi i aktiviteteve të lobimit në të gjitha vendet, si dhe miratimi i ligjit për lobim, regjistri i detyrueshëm i lobistëve dhe një organ i pavarur përgjegjës për menaxhimin e regjistrimit.

Vetëdija

-  Promovimi i mekanizmave që e rrisin pjesëmarrjen e qytetarëve dhe të ekspertëve në procedurat parlamentare.
-  Sigurimi i pjesëmarrjes së profesionistëve për ta vlerësuar ndikimin e ligjeve dhe të akteve të tjera para miratimit të tyre.
-  Publikimi i rregullt i të gjitha informacioneve që lidhen me konsultimet publike.
-  Krijimi i mekanizmave të reja ose forcimoi i mekanizmave ekzistues për vlerësimin e ndikimeve të mundshme të ligjeve ekzistuese dhe propozim-ligjeve (duke i përfshirë vlerësimet rregullatore, RIA).
-  Vendosja e pjesëmarrjes, transparencës dhe vlerësimit të cilësisë në kuadër të procesit RIA.
-  Forcimi politik i kuvendeve dhe i kompetencës së tyre për mbikëqyrje, në mënyrë që ata të mund ta vëzhgojnë punën e qeverive.

2.3 GJYQËSIA

Hapja e institucioneve gjyqësore në Ballkanin Perëndimor për vitin e tretë me radhë mbetet jashtëzakonisht e ulët. Gjykatat dhe prokuroritë përmbushin më pak se gjysmën e treguesve që e matin hapjen e tyre.

Rekomandimet e dhëna gjatë dy viteve të fundit për ta forcuar hapjen dhe transparencën e institucioneve gjyqësore nuk janë marrë parasysh, e as që zgjuan interesin e tyre. Kjo konfirmohet edhe me faktin se pothuajse gjysma e institucioneve gjyqësore në rajon nuk u përgjigjën në pyetësorët që iu dërguan atyre, të cila janë formuluar për ta shqyrtuar në mënyrë plotësuese hapjen e tyre.

Kur bëhet fjalë për prokuroritë në rajon, Mali i Zi dhe Kosova janë shembull të hapjes duke përmbushur 54% dhe 50% të treguesve të hapjes. Situata në lidhje me hapjen e gjykatave në rajon është e ngjashme, me ç'rast gjykatat në Mal të Zi dhe Shqipëri përmbushin 57% dhe 49% të treguesve, përkatësisht.



Për shkak të mungesës së ueb-faqeve zyrtare, mos publikimit të të dhënave themelore për punën e institucioneve, planeve të punës, raporteve dhe dokumenteve të tjera publike, si dhe mos publikimit të aktvendimeve të arsyeshme gjyqësore (ose “shpjegimeve në kuadër të aktgjykimeve”) numri i problemeve që duhet të zgjidhen për të arritur transparencë të plotë dhe hapje të institucioneve gjyqësore nuk zvogëlohet.

Pothuajse të gjitha vendet kanë sisteme për shpërndarjen e rastësishme të lëndëve në institucionet gjyqësore. Ato janë me rëndësi thelbësore për pavarësinë dhe paanshmërinë e gjyqësisë. Por, për ta parandaluar keqpërdorimin eventual, duhet të vendosen kontrole më të forta mbi këtë sistem.

Marrëdhëniet e institucioneve me mediat mbeten të pazgjdhura. Një numër i madh i prokurorive ende nuk kanë miratuar asnjë direktivë për bashkëpunim me mediat, si dhe për mënyrën e raportimit.

HAPAT E VEPRIMIT

Transparenca

- ☒ Të gjitha institucionet gjyqësore duhet të kenë ueb-faqe të tyre që do të azhurnohen rregullisht me të gjitha informacionet përkatëse dhe të do të kenë mjet funksional për kërkim.
- ☒ Ueb-faqet zyrtare duhet t'i përmbajnë të gjitha informacionet që gjenden tabelat e shpalljeve nëpër gjykata dhe prokurori.
- ☒ Publikimi i planeve të punës dhe i raporteve për aktivitetet e realizuara në tre vitet e fundit në ueb-faqet zyrtare (tremujore/gjysmë-vjetore/vjetore), si dhe i strategjive aktuale që i zbatojnë institucionet.
- ☒ Publikimi i të gjitha dokumenteve financiare, përfundimtare dhe gjysmë-vjetore, i të gjitha institucioneve gjyqësore në ueb-faqe (buxhetet vjetore, shpenzimet buxhetore dhe raportet përkatëse, rebalanci i buxhetit).

- ☒ Publikimi i të dhënave për rrogat e prokurorëve, gjyqtarëve, anëtarëve të këshillave gjyqësorë dhe këshillave të prokurorëve dhe zyrtarëve të tjerë në ueb-faqet zyrtare.
- ☒ Publikimi i tabelave organizative në ueb-faqet zyrtare të institucioneve gjyqësore, si dhe biografitë dhe detajet e kontaktit të gjyqtarëve dhe të prokurorëve.
- ☒ Publikimi i të gjitha dokumenteve që lidhen me procedurat e furnizimeve publike, duke i përfshirë edhe planet vjetore, thirrjet e hapura, vendimet për furnizime dhe kontratat e lidhura, me çdo ndryshim të lidhur. Rekomandohet që këto dokumente të publikohen në ueb-faqet zyrtare të të gjitha institucioneve gjyqësore.
- ☒ Krijimi dhe implementimi i strategjive që sigurojnë hapje dhe transparencë.
- ☒ Sigurimi se të gjitha informacionet janë publikuar në format të hapur të të dhënave.

Disponueshmëria

- ☒ Ueb-faqet e institucioneve gjyqësore duhet të përmbajnë informacione për personin përgjegjës për qasje në informacione të rëndësishme për publikun, si dhe udhëzime të azhurnuara për qasje të lirë në informata.
- ☒ Lista e informatave me karakter publik duhet të azhurnohet dhe të vendoset në ueb-faqet zyrtare.
- ☒ Arkivi i të gjitha dokumenteve duhet të mirëmbahet rregullisht dhe të publikohet në ueb-faqet zyrtare.
- ☒ Publikimi i kërkesave të pranuar për qasje në informata, si dhe i informatave që tashmë janë dhënë.
- ☒ Trajnimi i zyrtarëve përgjegjës për trajtimin e kërkesave të qasje të lirë në informata.

- ✚ Vendosja e sistemeve për shpërndarjen e rastësishme të lëndëve nëpër prokurori.
- ✚ Krijimi dhe mirëmbajtja e bazave elektronike të të dhënave të aktgjykimeve gjyqësore.
- ✚ Publikimi i vendimeve të arsyeshme gjyqësore (ose “arsyetimeve në kuadër të aktgjykimeve”), procesverbaleve gjyqësore dhe mendimeve të ndara të anëtarëve të komisionit, si dhe i aktakuzave të konfirmuara.
- ✚ Themelimi i një departamenti special për komunikimin me publikun.
- ✚ Vendosja dhe zbatimi konsekuent i procedurave për bashkëpunim me mediat, duke përfshirë edhe publikimin e rregullt të komunikatave për mediat dhe azhurnimin e ueb-faqeve të gjykatave dhe të prokurorive publike.
- ✚ Sigurimi se dokumentet janë publikuar edhe në gjuhët e bashkësive pakicë në vend, por gjithashtu edhe se përfshijnë interpretues në gjuhën e shenjave dhe e përdorin alfabetin e Brejit.
- ✚ Përmirësimi i kapaciteteve të gjykatave dhe të prokurorive për personat me lëvizshmëri të zvogëluar.

Integriteti

- ✚ Publikimi i Kodeve të etikës në ueb-faqet zyrtare.
- ✚ Krijimi dhe publikimi i planeve të integritetit dhe i raporteve për zbatimin e tyre.
- ✚ Monitorimi dhe zbatimi i Kodit të etikës.
- ✚ Sigurimi se shkeljet e Kodit të etikës sanksionohen në mënyrë adekuate.

Vetëdija

- ☞ Dorëzimi me kohë i raporteve vjetore deri te institucionet përgjegjëse.
- ☞ Përmirësimi i raportimit deri te këshillat gjyqësorë dhe këshillat e prokurorive duke krijuar formularë të veçantë për raportim për punën e gjykatave dhe të prokurorive.
- ☞ Shtimi i informacioneve për masat disiplinore dhe ankesat, si dhe informacione për rastet e zgjidhura dhe aktvendimet e marra në raportet vjetore.

2.4. NJËSITË E VETËQEVERISJES LOKALE (KOMUNAT)

Niveli i hapjes së vetëqeverisjes lokale në Ballkanin Perëndimor për të tretin vit radhazi mbetet në nivel të pakënaqshëm. Hapja rajonale e këtyre institucioneve përmbush 36% të treguesve të hapjes, që është një përmirësim i vogël në krahasim me vitin e kaluar të matjes, ku treguesit ishin përmbushur me 31%.

Ngecja sa i përket hapjes së vetëqeverisjeve lokale është veçanërisht shqetësuese kur merret parasysh fakti se ato konsiderohen institucioni më i rëndësishëm për shërbim ndaj qytetarëve. Mbyllja e tyre dhe moskujdesi për mënyrën se si t'u lehtësohet qytetarëve qasja në shërbime dhe si të sigurohet pjesëmarrja e tyre në krijimin e politikave në komunitetin e tyre lokal, i dëmtojnë rëndë parimet themelore të demokracisë. Njësitë e vetëqeverisjes lokale duhet të ndër marrin hap serioz për promovimin e vlerave themelore të hapjes, me një angazhim dhe qasje më aktive.

Nevoja për qasje strategjike për ta përmirësuar hapjen e njësive të qeverisjes lokale është urgjente. Mirëpo, miratimi i dokumentit strategjik nuk është i mjaftueshëm. Duhet të insistohet në zbatimin e tij konsekuent përmes mbikëqyrjes dhe kontrollit të rreptë.

Një fakt pozitiv në krahasim me rezultatet e vitit të kaluar është se ka pasur përparim të konsiderueshëm në rezultatet e shkallës së hapjes së vetëqeverisjeve lokale në Kosovë, Shqipëri dhe Bosnjë

dhe Hercegovinë. Nga ana tjetër, hapja e vetëqeverisjes lokale në Serbi është e vetmja të cilën ka rënie, gjë që e potencion mungesën e përkushtimit të këtyre institucioneve për ta promovuar hapjen në periudhën e mëparshme.

Niveli rajonal i disponueshmërisë mbetet i ulët, duke përmbushur vetëm 27% të treguesve të hapjes. Në shumicën e rasteve, qytetarët mbeten të privuar nga informatat që lidhen me konsultimin publik. Ende ka mungesë të planeve, thirrjeve dhe raporteve nga konsultimet dhe debatet publike, të cilat duhet të përmbajnë shpjegime me shkrim dhe përgjigjet e dhëna të publikohen në ueb-faqe. E gjithë kjo i parandalon qytetarët të marrin pjesë në kohë në diskutimet dhe vendimet me rëndësi lokale. Procesi i publikimit të informatave dhe i dokumenteve në formatin e hapur të të dhënave mbetet i panjohur për nëpunësit publik të punësuar në këto institucione.

Gjithashtu, në ueb-faqet zyrtare nuk ka përmbledhje të informatave me rëndësi për publikun, të cilat janë të nevojshme për funksionimin e rregullt të vetëqeverisjeve lokale. Ato janë: informacioni i kontaktit të personit përgjegjës për qasje në informatat me rëndësi për publikun, zyrat e informacionit që do të shërbenin si qendra për dokumentim ose si baza të dhënash publike, përgjigjet e publikuara për kërkesat për informata publike, udhëzues të azhurnuar për qasjen e lirë në informata, ose një pjesë e veçantë për publikimin e informatave relevante për qasjen e lirë në informata.

Kur bëhet fjalë për nivelin e vetëdijes në rajon (49.12%), në krahasim me vitin e kaluar, është vërejtur rënie prej 5.15%. Rënia e nivelit është tregues se vetëqeverisjet lokale nuk e marrin seriozisht përkushtimin e tyre për menaxhimin strategjik të institucioneve. NJVL-të zakonisht nuk hartojnë strategji dhe plane aksionale për zbatimin e tyre. Ato gjithashtu kanë nevojë për tregues të performancës gjatë përgatitjes së programit vjetor të punës dhe raporteve për këshillat komunalë dhe kryetarët e vetëqeverisjeve lokale.

Kjo do të thotë që NJVL-të duhet të përqendrohen më shumë në krijimin e planeve aksionale me shkrim për zbatimin e strategjive të tyre të zhvillimit, për të siguruar një nivel më të lartë të vetëdijes. NJVL-të duhet të sigurohen se dokumentet janë publikuar në format të hapur të të dhënave dhe se janë përpiluar në mënyrë që është e kuptueshme për publikun e gjerë, duke e lehtësuar kështu mbikëqyrjen publike dhe ndikohet mbi përparimin dhe mangësitë e vetëqeverisjeve lokale.

Hulumtimi gjithashtu vuri në dukje një transparencë po aq të ulët në fushat e financave, të dhënave organizative, programeve vjetore dhe raporteve të punës, dokumenteve strategjike etj. Parimet e transparencës proaktive nuk respektohen, ndërsa informacionet nuk publikohen në format të hapur. Kapacitetet e nëpunësve shtetërorë nuk janë aq të forta sa t'i plotësojnë standardet e kërkuara të hapjes dhe transparencës.

HAPAT E VEPRIMIT

Transparenca

- ☞ Përmirësimi i organizimit dhe i menaxhimit të ueb-faqeve të vetëqeverisjes lokale. Zakonisht ato janë të padobishme dhe të organizuara në mënyrë jo sistematike, me mundësi të kufizuara për kërkim.
- ☞ Publikimi i planeve të punës dhe i raporteve për aktivitete të realizuara në tre vitet e fundit në ueb-faqet zyrtare (tremujore/gjysmë-vjetore/vjetore), duke i përfshirë edhe treguesit e performancës.
- ☞ Publikimi i të gjitha dokumenteve financiare, përfundimtare dhe gjysmë-vjetore, në ueb-faqe (buxhetet vjetore, shpenzimet buxhetore dhe raportet përkatëse, rebalanci i buxhetit).
- ☞ Publikimi i rregulloreve të punës dhe/ose i procesverbaeve të mbledhjeve të këshillave komunalë, së bashku me dokumentet e shqyrtuara në ato mbledhje dhe dokumentet e miratuara, në ueb-faqet zyrtare. Kjo gjithashtu përfshin përgatitjen e komunikatave për shtyp pas mbledhjeve.
- ☞ Publikimi i video transmetimeve dhe incizimeve nga mbledhjet e këshillave komunalë.
- ☞ Krijimi dhe publikimi i Buxhetit të qytetarëve.
- ☞ Publikimi i listës së nëpunësve shtetërorë dhe punonjësve të vetëqeverisjes lokale, me titullin e tyre të punës



dhe me të dhënat për rrogat në ueb-faqet zyrtare të vetëqeverisjes lokale.

- ☒ Publikimi i të gjitha dokumenteve që lidhen me procedurat e furnizimeve publike, duke i përfshirë planet vjetore, thirrjet e hapura, vendimet për furnizime dhe kontratat e lidhura, me çdo ndryshim të lidhur. Rekomandohet që këto dokumente të publikohen në ueb-faqet zyrtare të të gjitha vetëqeverisjeve lokale.
- ☒ Publikimi i të gjitha informacioneve në format të hapur të të dhënave.
- ☒ Publikimi i emrave dhe informatave të kontaktit të nëpunësve shtetërorë në ueb-faqet zyrtare.

Disponueshmëria

- ☒ Ueb-faqet e NJVL-ve duhet të përmbajnë informacione për personin përgjegjës për qasje në informacione të karakter publik, si dhe udhëzim të azhurnuar për qasje të lirë në informata.
- ☒ Lista e informatave me karakter publik duhet të azhurnohet dhe të publikohet në ueb-faqet zyrtare.
- ☒ Arkivi i të gjitha dokumenteve duhet të mirëmbahet rregullisht dhe të publikohet në ueb-faqet zyrtare.
- ☒ Publikimi i kërkesave të pranuar për qasje në informata, si dhe i informatave për të cilat tashmë është fituar qasje e lirë.
- ☒ Publikimi i informacioneve në format të hapur të të dhënave.
- ☒ Publikimi i udhëzuesit zyrtar për qasje në informata në ueb-faqet zyrtare.
- ☒ Rritja e diapazonit të kanaleve për komunikim me qytetarët (konsultime elektronike, komunikim përmes internetit dhe mediave sociale).

Integriteti

- Organizimi dhe pjesëmarrja në trajnime dhe punëtori që merren me politikën antikorupsion, konfliktin e interesit dhe spiunimin.
- Miratimi dhe publikimi i Planit për integritet në ueb-faqen zyrtare të NJVL-së.
- NJVL-të duhet të kenë politika të brendshme të përcaktuara qartë për luftë kundër korupsionit, që nënkupton masa për parandalimin dhe eliminimin e formave të ndryshme të korupsionit dhe sjelljes joetike brenda institucionit.
- Krijimi dhe mirëmbajtja e një kanali të drejtpërdrejtë në internet, përmes të cilit qytetarët mund të paraqesin ankesa dhe të shprehin shqetësime.

Vetëdija

- Publikimi i vlerësimeve dhe i raporteve të punës për tre vitet e fundit në ueb-faqet zyrtare.
- Sigurimi se programet vjetore të punës janë planifikuar në përputhje me treguesit e performancës.
- Përgatitja e strategjive të zhvillimit dhe e planeve aksionale.





3. METODOLOGJIA

Hapja është kusht kryesor për demokracinë pasi që u mundëson qytetarëve t'i marrin informatat dhe njohuritë e nevojshme për pjesëmarrje të barabartë në jetën politike, vendimmarrjen efikase dhe kërkimin e përgjegjësisë nga institucionet për politikatat që i zbatojnë.

Institucionet në gjithë botën ndërmarrin aktivitete konkrete për ta rritur transparencën dhe llogaridhënien e tyre ndaj qytetarëve. Për ta përcaktuar shkallën në të cilën qytetarët e Ballkanit Perëndimor marrin informata në kohë dhe të kuptueshme nga institucionet e tyre, u zhvillua një indeks rajonal i shkallës së hapjes.

Indeksi rajonal i shkallës së hapjes e mat shkallën në të cilën institucionet e Ballkanit Perëndimor janë të hapura për qytetarët dhe shoqërinë, duke u bazuar në katër parime: (1) transparenca (2) qasja (3) integriteti dhe (4) efikasiteti.

Parimi i transparencës nënkupton se informacionet e organizatës, buxheti dhe procedurat për furnizim publik janë në dispozicion dhe se publikohen. Qasja ka të bëjë me sigurimin dhe respektimin e procedurave për qasje të lirë në informata dhe rritjen e qasjes në informata përmes mekanizmit të debateve publike dhe forcimit të bashkëveprimit me qytetarët. Integriteti përfshin mekanizma për parandalimin e korrupsionit, zbatimin e

Kodeve etike dhe rregullimin e lobimit. Parimi i fundit, efikasiteti, ka të bëjë me monitorimin dhe vlerësimin e politikave që i zbatojnë institucionet.

Duke i ndjekur standardet, rekomandimet dhe shembujt ndërkombëtarë të praktikës së mirë, këto parime janë përpunuar më tej përmes treguesve specifikë sasiorë dhe cilësorë që vlerësohen në bazë të disponueshmërisë së informatave në ueb-faqet zyrtare të institucioneve, cilësinë e kornizës ligjore për çështje individuale, burimeve të tjera të informatave me karakter publik dhe pyetësorëve për institucionet.

Matja është realizuar nga dhjetori i vitit 2018 deri në fund të marsit të vitit 2019. Mbledhja e të dhënave u pasua nga një proces i verifikimit të të dhënave, duke rezultuar me një gabim standard prej +/- 3%. Duke u bazuar në rezultatet e hulumtimit, zhvilluam një sërë rekomandimesh dhe udhëzimesh për institucionet.



4. RRETH PROJEKTIT

Qeverisja e mirë është thelbësore për sundimin e të ligjit. Përderisa çështjet që lidhen me korrupsionin, transparencën, sundimin e ligjit dhe qeverisjen e mirë janë vazhdimisht në fokus, ekziston mungesë e të kuptuarit të problemeve sistemore që nuk janë të mbuluara sa duhet.

Projekti "Përgjegjësi, Teknologji dhe Rrjet i institucioneve të hapura në Evropën Juglindore (ACTION SEE)", ka për qëllim ta ngrëjë vetëdijen për sfidat e këtilla duke e lehtësuar bashkëpunimin ndërmjet organizatave qytetare dhe duke i konsoliduar përpjekjet strategjike për avokim për përfaqësim.

ACTION SEE ofron një platformë për dialog dhe një mjet konkret për ta matur shkallën në të cilën institucionet shtetërore i respektojnë parimet dhe standardet e qeverisjes së hapur (indeksi i shkallës së hapjes).

Qëllimi i projektit është që të rrisë përfshirjen e shoqërisë civile dhe organizatave mediatike në krijimin e opinionit publik, krijimin e politikave dhe pjesëmarrjen në mekanizmat e vendimmarrjes, si dhe t'i rrisë kapacitetet e shoqërisë civile për t'i adresuar çështjet e ndjeshme.

Qëllimet specifike të projektit:

- + Promovimi i një shoqërie civile dinamike që i mobilizon në mënyrë efektive qytetarët për t'i përfshirë ata në mënyrë aktive në çështje që lidhen me sundimin e ligjit dhe qeverisjen e mirë dhe ndikimin e politikave dhe proceseve të vendimmarrjes në nivel kombëtar dhe rajonal.

- + Forcimi i mekanizmave të dialogut midis organizatave të shoqërisë civile dhe institucioneve qeveritare dhe ndikimi në qeverisjen e mirë dhe reformat e administratës publike.

- + Inkurajimi i rrjetëzimit të organizatave të shoqërisë civile dhe organizatave mediatike në nivel rajonal dhe në nivel të BE-së, duke mundësuar shkëmbimin e njohurive, aftësive dhe lidhjeve dhe rritjen e ndikimit të përpjekjeve të tyre për përfaqësim.

ACTION SEE është rrjet i organizatave të shoqërisë civile që punojnë së bashku për të promovuar dhe për të siguruar llogaridhënie dhe transparencë të autoriteteve në rajonin e Evropës Juglindore, për ta rritur potencialin për aktivizëm qytetar dhe pjesëmarrjen e qytetarëve, për t'i promovuar dhe për t'i mbrojtur të drejtat dhe liritë e njeriut në internet dhe për t'i ndërtuar kapacitetet dhe interesin midis organizatave të shoqërisë civile dhe individëve në rajon për përdorimin e teknologjisë në përparimin e demokracisë.

Projekti ACTION SEE, i financuar nga Bashkimi Evropian, zbatohet nga Fondacioni Metamorfozis, Fondacioni Westminster për Demokraci, Qendra për Hulumtim, Transparencë dhe Llogaridhënie (CRTA – Center for Research, Transparency and Accountability), Shoqata e qytetarëve "Pse jo?" (Citizens Association Why not?), Qendra për tranzicion demokratik (Center for Democratic Transition), Të dhënat e hapur Kosovë (Open Data-Kosovo (ODK)) dhe Lëvizja Mjaft!.

5. LEXONI MË SHUMË

Udhërrëfyesit për secilin vend:

Shqipëria

<https://bit.ly/2EYBIXL>

BdheH

<https://bit.ly/2Qeeah4>

Kosova

<https://bit.ly/2PUqtik>

Maqedonia e Veriut

<https://bit.ly/2RyFnNB>

Mali i Zi

<https://bit.ly/2PBbsTG>

Serbia

<https://bit.ly/2POmViP>



